



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr 3936 prot

Berat më 28 / 07 / 2021

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ” GAZMEND TOSKA

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ” GAZMEND TOSKA

KRYETARI

ERVIN DEMO

Konfirmoi : Petro Sinjari , Drejtor i Drejtorisë Juridike

Konceptoi : Majlinda Ramaj, Drejtorja e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë

Datë _____

Nr i faqeve A4 të projektvendimit : 1

Nr i faqeve A4 të relacionit : 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr 3935 prot

Berat më 28 / 07 / 2021

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ” KITA SALLABANDA

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ” KITA SALLABANDA

KRYETARI

ERVIN DEMO

Konfirmoi : Petro Sinjari , Drejtor i Drejtorisë Juridike

Konceptoi : Majlinda Ramaj , Drejtorja e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë

Datë _____

Nr i faqeve A4 të projektvendimit : 1

Nr i faqeve A4 të relacionit : 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT
“QYTETAR NDERI ” KITA SALLABANDA

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, si një ndër prioritetet e saj, ka dhe vlerësimin e personave me merita dhe kontribute të veçanta për vendin, përkushtimin ndaj Republikës së Shqipërisë, interesave kombëtare, shoqërisë dhe komunitetit. Për këtë, ne si institucion drejtohem nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015, me kërkesë të një grupi qytetarësh të qytetit të Beratit, ardhur në Institucion më datë 05.11.2020 me nr.5384 Prot. për Kita Sallabanda, me profesion mjek, me kontribute në fushën e mjekësisë, në komunitetin beratas, në mjekësinë shqiptare dhe atë në nivel botëror, si edhe në atë të sferës së kërkimeve dhe botimeve shkencore; me ndjenja humanizmi për shërbime edhe në kauza të tjera; me cilësi patriotizmi për të bërë të njohur vlerat e qytetit tonë përtej kufirit; me detyra të rëndësishme në nivel përfaqësimi të autoritetit shqiptar; propozojmë që Profesor Kita Sallabanda, ti jepet titulli ‘Qytetar Nderi’.

Profesor Kita Sallabanda, vjen nga një familje e nderuar e qytetit tonë të lashtë të Beratit. Vitet e bukura të fëmijërisë dhe rinisë i kaloi në qytetin e Beratit, ku shkollën 8-vjecare e kreu në lagjen Murat Celebi dhe më vonë vazhdoi gjimnazin B.D.Karburnara. Studimet e larta i kreu në fakultetin e mjekësisë, Tiranë. Pas mbarimit të universitetit, u emërua mjek i përgjithshëm për t’i shërbyer banorëve të Maqellarës. Më vonë, doktor Sallabanda shërbeu si neurokirurg në Tiranë. Pavarësisht ushtrimit të profesionit në Tiranë, ai u është gjendur bashkëqytetarëve të vet jo vetëm në rolin e doktorit të mirë, por edhe në mbështetjen dhe zgjidhjen e shumë halleve dhe problemeve familjare e personale.

Një nga vlerat më të spikatura të doktor Kitës është kontributi i tij në vitet e vështira 1996-1998. Për cdo problem të tyre shëndetësor, qytetarët i drejtoheshin spitalit, ku Profesori kryente profesionin e mjekut dhe ai përgjigjej menjëherë me helikopterin e Ministrisë së Shëndetësisë, që ulej tek fusha e sportit, për të marrë të sëmurin që kërkonte ndihmë urgjente. Është i shumë numri i qytetarëve të Beratit, që tregojnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

historitë e tyre dhe familjarëve të tyre, të operuar, kujdesur e shëruar; por edhe shumë të tjerë që tregojnë sesi u është gjendur doktori pranë. Kanë qenë ato vite të vështira, ku

sakrificat e tij në këtë periudhë nuk kanë qenë vetëm për komunitetin beratas. Ishte koha kur plumbat vërshellenin nga të gjitha anët dhe doktor Kita ka qenë një nga mjekët e pakët, që qarkullonte nga jugu ne veri, duke vënë jetën e tij në rrezik, dhe kjo kohë mban në memorien e vet histori të bukura, por dhe të dhimbshme të profesionit të tij të mjekut të atyre viteve.

Në vitet 1997-2000, Profesor Kita Sallabanda u ngarkua me detyrën e Konsullit të Spanjës dhe mori pjesë aktive në shpalljen e Beratit “Qytet i Mbrojtur nga UNESCO”, duke siguruar jo vetëm votën e Spanjës, por edhe të vendeve të tjera mike. Gjithashtu, si Konsull i Spanjës ishte në krye të trupave spanjolle në operacionin “Alba”. Në vitet 1998, dërgoi disa herë helikopterë ushtarake në ndihmë të njerëzve, që kërkonin ndihmë mjekësore në Berat, dhe organizoi me dashuri kampin spanjoll për refugjatët kosovarë gjatë Luftës së Kosovës.

Doktor Kita është nderuar nga Mbreti i Spanjës, me titullin e Lartë “Encomienda de Orden de Merito Civil”, titull që u jepet njerëzve të shquar dhe me traditë fisnike në Spanjë. Pavarësisht se mjeku u largua në Spanjë, Madrid, Doktor Kita Sallabanda nga kishte dhe origjinën nëna e tij, asnjëherë nuk u shkëput nga Berati e nga njerëzit e tij. Për këtë flasin shumë miqtë dhe të njohurit e tij. Në Spanjë, ai mori titullin Profesor Kita Sallabanda, Profesor i Neurokirurgjisë të Universitetit Komplutense të Madridit, Universitetit më të njohur të Spanjës, ku punon si neurokirurg dhe është një nga figurat më të njohura të neurokirurgjisë në Spanjë, President i Shoqates Spanjolle të Radiokirurgjisë dhe një figurë e njohur në botë duke u bërë President i Shoqatës Latino-Amerikane të Radiokirurgjisë. Profesor Kita Sallabanda është autor i 3 librave dhe mbi 35 artikujve shkencore, pjesëtar i grupeve të studimeve shkencore, në fushën e mjekësisë në Europë dhe në botë.

Profesor Kita Sallabanda është nderuar me medaljen e artë të Akademisë Mbretërore të Mjekësisë së Spanjës dhe në vitin 2020 është kandidat i Cmimit Kombëtar në Mjekësi, cmim që ju jepet mjekëve më të nderuar të Spanjës. Ai është shpallur dhe pjesëtar i “Albanian Excellence” për qytetin e Beratit, përpara disa vitesh, sëbashku me disa qytetarë të tjerë.

Puna e tij është në vazhdimësi të pandërprerë edhe në këto momente të vështira të përballimit të situatës së pandemisë së Covid – 19. Ai është bërë pjesëtar i një numri të madh familjesh duke i këshilluar, ndihmuar dhe mësuar. Të vecanta janë momentet, kur mjeku me shumë kontribute dhe vlera, shfaqet në ekranet e televizionit për të dhënë këshilla dhe orientime, që janë bazë e përballimit të infektiveve nga virusi. Është vlerë për të gjithë ne, që një personalitet si Profesor, doktor Kita Sallabanda, me kaq shumë kontribute të spikatura në shumë drejtime për qytetin tonë, kombin tonë dhe me gjerë, në arenën akademike mjekësore ndërkombëtare, të propozojmë për ti dhënë këtë titull.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

Për sa më sipër, propozojmë:
Të miratohet propozimi i dhënies së titullit ‘Qytetar Nderi’ Profesorit Kita Sallabanda.
Faleminderit .

DREJTORI
Majlinda Ramaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI KESHILLIMOR

PROJEKTVENDIM
Nr. ____, datë, __/__/2021

“MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TE DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ”
KITA SALLABANDA

Komisioni Keshillimor pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë mbështetur në mbështetur në ligjin, Ligji nr. 112/2013 “për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në republikën e Shqipërisë” nenet 15,16, 20/ç, Vkm 861, për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Ti rekomandoje Keshillit Bashkiak Berat dhenien e titullit” Qytetar Nderi” te Bashkise Berat Z. Kita Sallabanda”
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KOMISIONIT

Kozeta Mushi
[Signature]

Bashkia Berat “Bulevardi Republika” Berat 5001



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI KESHILLIMOR

PROJEKTVENDIM
Nr. ____, datë, __/__/2021

“MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TE DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ”
GAZMEN TOSKA

Komisioni Keshillimor pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë mbështetur në mbështetur në ligjin, Ligji nr. 112/2013 “për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në republikën e Shqipërisë” nenet 15,16, 20/ç, Vkm 861, për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Ti rekomandoje Keshillit Bashkiak Berat dhenien e titullit” Qytetar Nderi” te Bashkise Berat z. Gazmen Toska”.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KOMISIONIT

Kozeta Musku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI KESHILLIMOR

PROJEKTVENDIM
Nr. ____, datë, __/__/2021

“MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TE DHËNIES SË TITULLIT “QYTETAR NDERI ”
GAZMEN TOSKA

Komisioni Keshillimor pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë mbështetur në mbështetur në ligjin, Ligji nr. 112/2013 “për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në republikën e Shqipërisë” nenet 15,16, 20/ç, Vkm 861, për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Ti rekomandoje Keshillit Bashkiak Berat dhenien e titullit” Qytetar Nderi” te Bashkise Berat z. Gazmen Toska”.
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KOMISIONIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT
“QYTETAR NDERI ” GAZMEN TOSKA

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, si një ndër prioritetet e saj, ka dhe vlerësimin e personave me merita dhe kontribute të vecanta për vendin, përkushtimin ndaj Republikës së Shqipërisë, interesave kombëtare, shoqërisë dhe komunitetit. Për këtë, ne si institucion drejtohem nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015, në institucionin tonë ka ardhur një kërkesë nga nje grup qytetarësh, më datë 23.02.2021 me Nr.1121 Prot. për Gazmen Toska, për dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi’.

Gazmen Toska është me profesion inxhinier, me kontribute në disa fusha të ndryshme për komunitetin beratas e të gjithë kombin tonë, si në atë të hapjes së një fasonerie, të mbështetjes së kulturës sonë beratase; si dhe kultivimin e humanizmit. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, janë punësuar një numër i konsiderueshëm qytetarësh pranë biznesit të tij të fasonerisë, ka ofruar ushqim për persona në nevojë, si dhe ka siguruar mbështetje të vazhdueshme për muzeum Solomon, të kthyer tashmë në një qendër kulturore të mirëfilltë; Gjithashtu, janë dhuruar maska gjatë periudhës së pandemisë.

Gazmen Toska ka lindur në qytetin e Beratit, ku ka ndjekur arsimin e mesëm në Shkollën e Mesme Industriale të Beratit. Më pas, ka filluar shkollën për inxhinieri mekanike në Universitetin e Tiranës dhe kur ishte në vitin e dytë, vazhdoi studimet në Francë. Sot, Ing. Gazmen Toska është një ndër sipërmarrësit më të suksesshëm të qytetit të Beratit, e në të njëjtën kohë edhe një nga figurat më të dashura nga banorët e qytetit e më gjerë.

Zoti Toska ka themeluar edhe një fondacion me po të njëjtin emër, ‘Fondacioni G Toska’, i cili ka në fokus ndërtimin e urave të komunikimit midis popujve dhe për këtë arsye është shumë aktiv në fushat humanitare, të edukimit, gjuhës dhe kulturës franceze. Nëpërmjet këtij fondacioni Ing. Gazmen Toska vazhdon të japë kontribut për qytetin në mënyra të ndryshme si:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

- duke ofruar vakte ushqimore për personat në nevojë dhe ata të pastrehë (Restoranti Humanitar “Porta e Hapur” shërben çdo drekë 50 vakte falas njerëzve në nevojë),
- duke mbështetur vazhdimisht muzeun Solomon, që dëshmon dhe sjell fakte mbi historinë e hebrenjve në Berat,
- duke dhuruar ndihma të ndryshme sipas rastit për familjet e prekura nga varfëria dhe katastrofat natyrore, etj.
- duke ofruar ndihmë me pajisje mjekësore për personat në nevojë
- duke mbështetur botimin e librave kulturorë në shqip dhe frengjisht
- ofrimi i bursave të studimit për nxënësit me arritje të shkëlqyera

Po ashtu, në biznesin e tij privat në fushën e fasonerisë janë të punësuar rreth 250 qytetarë të Beratit, numër ky që pritet të rritet deri në 400 së shpejti.

Është krenari që një personalitet i tillë me kontribut në fusha të ndryshme e në të mirë të komunitetit Beratas, të shpërblehet për të mirat që ka bërë në vite.

Për sa më sipër, propozojmë:

Të miratohet propozimi i dhënies së titullit ‘Qytetar Nderi’ Ing. Gazmen Toska.

Faleminderit .

DREJTORI
Majlinda Ramaj